



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2 pika (h), nenin 106 të Ligjit Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 8.2 dhe nenin 26 të Ligjit Nr.03/L-072 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 04.05.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq

- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotim dhe në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve, si dhe kur të gjitha vërejtjet që u përkasin procesit të votimit dhe numërimit janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, KQZ certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq, të mbajtura më datën 23 prill 2023.
- II. Rekomandimi për certifikim dhe rezultatet e zgjedhjeve për kuvendin komunal, si në pikën I, i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
- III. Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.05.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniq





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Për : Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Nga: Burim Ahmetaj: Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së

Data: 04.05.2023

Lënda: Rekomandim për certifikimin e rezultateve për zgjedhjet e parakohshme për kuvendin Komunal në Leposaviq

Të nderuar,

KQZ, bazuar në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, certifikon rezultatet e zgjedhjeve në pajtim me nenin 64.2 pika (h) dhe nenin 106, rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja.

KQZ-ja, i publikon rezultatet e zgjedhjeve pasi që ato të jenë certifikuar, dhe njëherit i publikon rezultatet në bazë të nenit 106 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, publikon rezultate përfundimtare në formë tabelore, duke përfshirë edhe **numrin e votave të fituara për secilin kandidat individual.**

Vendet – mandatet, për çdo Kuvend të Komunës, ndahen në bazë të nenit 8 të Ligjit për zgjedhjet lokale, duke respektuar formulën si në vijim:

- numrin e përgjithshëm të **votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik dhe**
- koeficientin që rezulton nga vargu i pjesëtimeve, sipas renditje zbritëse.

Vendet- mandatet, iu ndahen subjekteve politike sipas koeficienteve në mënyrë që vendi i parë i takon subjektit që e ka koeficientin më të madh, vendi i dytë subjektit që e ka koeficientin e radhës më të madh, e kështu me radhë derisa të ndahen **të gjitha vendet në Kuvendin Komunës përkatës.**

Sipas nenit 8 paragrafi 2 të Ligjit për zgjedhjet lokale, të gjitha **votat e fituara nga kandidatët** që janë në listën e kandidatëve të çdo subjekti politik, numërohen ndaras, ndërsa, listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat.

Andaj, Sekretariati i rekomandon KQZ-së certifikimin e rezultateve sipas tabelës në vijim:

Komuna / Opstina		Leposaviq /Leposavić		
	Subjekti politik/ Politički subjekt	Vota/Glasovi	Përqindja/ Procentat	Numri i ulëseve të fituara
115	Lëvizja VETËVENDOSJE!	83	76.1%	15
112	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	21	19.2%	2
113	PARTIA KOSOVSKIH SRBA	5	4.6%	2

Kandidatët e zgjedhur në Komunën e Leposaviqit

Nr. Rendor	Numri i kandidatit	Subjekti Politik	Kandidati-tja	Total
1	1	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	LULZIM HETEMI	83
2	2	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	VLORË ALIU	13
3	3	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	BAHRI HASANI	12
4	4	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	ESET MUSA	2
8	8	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	QENDRESA HETEMI	7
9	9	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	ASLLAN ALIU	1
10	10	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	LEDIONA HAJDARI	2
11	11	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	ESHREF BEKTESHI	15
12	12	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	BLERIM BEHRAMI	2
13	13	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	SELVETE MURSELI	1
14	14	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	SABRI FETAHU	1
15	15	Lëvizja VETËVENDOSJE! - LVV	DRITON HETEMI	5
19	1	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	ADEM ADEMI	21
20	2	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	ALBULENA BEHLULI HETEMI	10
21	1	PARTIJA KOSOVSKIH SRBA	DRAGAN JABLANOVIĆ	5
27	7	PARTIJA KOSOVSKIH SRBA	GORSKI BURIĆ	1